

VENDIM
Nr.1637, datë 17.12.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI AGJENCISË
KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista përbëhet nga 1 (një) fletë dhe përfundon me numrin rendor 1 (një).

2. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, kryetari i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

Institucioni i Pushtetit Qendror: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

bashkia/komuna:Tiranë (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore)

Fusha e përdorimit të pronës: Studimore, projektuese, shkencore në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbureve dhe hidroenergjetike

Nr.rend.	A			B			C			
	Zona kadastr. Indeksi i hartës	Nr.pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sip.total e pronës (m ²)	Nga sip. tot. sa ndërtesë m ²	Funksioni për të cilin përdoret prona	Ins/enti me përgjegjësi administrative	Inst/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	8260		Truall ndërtesë	Ish-instituti TNPM-Tiranë	1796.0	960.94	Zyra për AKBN me qëllim ushtrimin e veprimtarisë studimore, projektuese, shkencore, në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbureve, hidroenergjetike etj.	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Statusi juridik i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.547, datë 9.8.2006 me ndryshimet përkatëse	Bashkëlidhur këtij formulari jepet planvendosja e ish-ITNPM-së bashkë me anekset dhe sh.1:500 dhe dimensionet kryesore planimetrike të objekteve. Jepet gjithashtu dhe numri i kateve për çdo objekt
				1. Ndërtesa e ish-ITNPM	448.61	448.61				
				2. Ndërtesa e laboratorit të pasurimit të mineraleve	246.13	246.13				
				3. Ndërtesa e impiantit të pasurimit të mineraleve	205.8	205.80				
				4. Ndërtesa e oficinës	37.3	37.3				
				5. Ndërtesa e garazhit	23.1	23.1				
				6. Oborri i ITNPM-së (sipërfaqja funksionale).adresa: blloku "Vasil Shanto" Ruga:Bajram Curri	835.06					

